



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Mobelland" Sh.P.K. të datës 19.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Mobelland" Sh.P.K. të datës 19.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1.
- II. **MBETET NË FUQI** njoftimi mbi vendimin i datës 17.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Mobelland" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme ndërsa oferta e parashtruesit është në tërësi e përgjegjshme ndërsa arsyet për eliminimin e parashtruesit nga aktiviteti i prokurimit janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se përmes vendimit të dt. 17.07.2024 është anuluar në tërësi aktiviteti i prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme bazuar në nenin 62 të LPP. Ky vendim është i bazuar në mënyrë derivative në vendimin e OSHP të datës 15.07.2024 me shenjën OSHP:2024/0372 përmes të cilit është konfirmuar se të gjitha ofertat e dorëzuara janë të papërgjegjshme. Në këtë mënyrë është gjetur se të gjitha pretendimet e parashtruesit janë trajtuar jo vetëm nga AK por edhe nga OSHP. Në këtë mënyrë është gjetur se aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet në mungesë të ofertave të përgjegjshme duke u bazuar në vendimin e OSHP dhe duke u mbështetur në nenin 62 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 23.07.2024**

**Visar SHEHU**  
  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.